



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:150080  
Datë: 27.11.2023  
Numri i dokumentit: 04974060  
**P.nr.80/23**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarës Gj. G. , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënparag.1.4 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.11/23 të dt. 06.07.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 21.12.2023, ku prezent ishin prokurori i shtetit Qazim Xharra, e akuzuara Gj. G.me mbrojtësin e saj, av. Haki Kryeziu me autorizim, i dëmtuari B. G., dhe mbrojtësja e viktimave Gj. D., me dt. 22.11.2023, shpallë, ndërsa me dt.27.11.2023, e përpilon këtë:

### A K T G J Y K I M

**E AKUZUARA: G. G.**, nga i ati H.dhe e ëma Sh. e lindjes R., e lindur më datën ... në fsh. S.K.K. , tani me vendbanim në fsh. K. komuna M., me nr. personal ..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, e ëma e ... fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike.

### Ë S H T Ë F A J T O R E

Me datë 28.12.2022 rreth orës 08:55 në fshatin K. K-M., saktësisht në shtëpinë e tyre familjare, e pandehura me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit/bashkëshortit të saj B. G., në atë mënyrë që ditën kritike pasi që i dëmtuari kthehet në shtëpi, e pandehura i thot të dëmtuarit se ti vjen në shtëpi veq me hanger najsen si dhe e fyen me fjalë të ndryshme, pastaj e shtyen të dëmtuarin të cilin e ul në divan dhe e godet me shuplakë në fytyrë, me ç' rast e pandehura të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkuara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të dr.A. G. datë 24.01.2023.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale **Lëndim i lehtë trupor** nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4,7,17, 38, 39, 40, 43, 69 si dhe nenit 185 par 1 nënpar. 1.4 të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjten e:

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë në lartësi prej 300 € (treqind ) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar më gjobë do të iu zëvendësohet me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke llogaritur çdo 20 euro në një ditë burgu.

E akuzuara lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat bijnë në xhirollogari të gjykatës.

### A r s y e t i m

#### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/IL.nr.11/23 të dt. 06.07.2023, e ka akuzuar të akuzuarën G. G., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënparag.1.4 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarën ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 21.11.2023 ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Q. Xh., e akuzuara Gj. G. me mbrojtësin e saj av. Haki Kryeziu, i dëmtuari B. G. si dhe mbrojtësja e viktimave Gj.D., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

E akuzuara Gj. G. , në shqyrtimin fillestar është deklaruar e fajshme, për veprën për të cilën ngarkohet, me bashkëshortin jetojmë së bashku, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, nga ajo kohë nuk kemi kurrfarë problemi.

Mbrojtësi i të akuzuarës Gj. G., Av. Haki Kryeziu në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Meqenëse e mbrojtura ime në seancën e sotme e pranoj fajësinë, i propozoj gjykatës që si rrethana lehtësuese ta merr faktin se asnjëherë në jetën e sajë, nuk ka ra ndesh me ligjin, po ashtu edhe me parë nuk ka pasur probleme me bashkëshortin kanë jetuar dhe jetojnë së bashku është në përkujdesje të tij 24 orë, meqenëse është në tretman të vazhdueshëm mjekësor nuk kanë të ardhura personale , jetojnë më një pension invalidor në shumë prej ... euro, është nën e ... fëmijëve, prandaj i propozoj gjykatës që në rastin e shqiptimit të ndonjë dënimi ti ketë parasysh këto rrethana dhe ti shqiptohet një dënim sa më i butë.

I dëmtuari B. G. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë së të akuzuarës ,nuk i bashkangjaitem ndjekjes penale dhe nuk parashtoj kërkesë pasurore juridike, jetojmë së bashku ne harmoni, nuk kemi kurrfarë probleme në mes vete, jam i varur prej sajë-bashkëshortes pasi që ajo përkujdeset dhe unë jam në tretman të vazhdueshëm mjekësor.

Mbrojtësja e viktimave Gj. D. deklaron: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga e akuzuara si dhe e mbështes deklarinimin e të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Duke pasur parasysh se e akuzuara e pranoi fajësinë, paraprakisht duke e kuptuar natyrën, pasojat dhe favoret e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pas këshillimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e sajë, po ashtu faktin se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes respektivisht provave materiale dhe personale që përmban aktakuza, e në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj aktakuze, ku edhe përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale me të cilën ngarkohet, po ashtu faktin se aktakuza është e ligjshme dhe se provat të cilat i përmban janë prova të nxjerrura në bazë të rregullave të përgjithshme mbi provat, prokuroria e shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së të akuzuarës. Gjykatës i propozoj që të akuzuarën ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim të paraparë me ligj duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar të gjitha rrethanat si ato lehtësuese siç është pranimi i fajësisë në këtë shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethanat rënduese të ketë faktin se vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara e cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se e akuzuara i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se e akuzuara Gj.G., me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënparag.1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i policit S. H., dt.28.12.2022;
- Akt ekspertimi mjeko ligjor i ekspertit dr.A. G., datë 24.01.2023;
- Raporti mjekësor me numër ... datë 28.12.2022 i lëshuar nga Q. në Malishevë;
- Deklarata e të dëmtuarit B. G., e dhënë në polici me dt.28.12.2022;
- Deklarata e të pandehurës Gj. G., e dhënë në polici me dt.28.12.2022;
- Si dhe shkresat tjera në lëndë.

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 185 par.1 nënparag.1.4 të KPRK-së, është parashikuar se „  
1. *Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

#### 5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarën Gj.G., e ka shpallur fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e saj të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënparag.1.4 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës, pranimin e fajësisë, pendimin e saj, është e ëma e 5 fëmijëve, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale, i dëmtuari B. G. nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, ka deklaruar se jetojnë se bashku dhe i kanë raportet e mira, e njëjta përkujdeset për mua pasi që jam në tretman mjekësor, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marrë faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, me ç' rast gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, të cilën shumë e akuzuara është e obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

#### 7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil.

I dëmtuari B. G. nuk është udhëzuar në kontestin civil, pasi që i njëjti nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarës.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi lirimin e të akuzuarës nga shpenzimet e procedurës është marr konform nenit 452 par.4 të KPPK- së për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohej gjendja materiale e të akuzuarës, pasi që jetojnë me një pension invalidor të bashkëshortit në shumë prej 75 euro, e kjo u vërtetua nga vendimi me nr. te dosjes ...., ku i njëjti gjykatës ia ka dorëzuar një kopje te vendimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.80/23, me dt.22.11.2023.**

Sekretarja juridike  
**Behije Karaçica**

Gjyqtari i vetëm gjykues  
**Lulzim Paçarizi**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.